



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:275021
Datë: 13.05.2024
Numri i dokumentit: 05753963

KA.nr. 213/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NTP “Mali-I” me seli në Mitrovicë, të cilin e me autorizim e përfaqëson avokat Zeqir Fetoshi me seli në rrugën “Bedri Berisha”, hyr. B, kati I/15-1, nr. 342, në Prishtinë, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të aktit administrative, jashtë seancës më 13 maj 2024 mori këtë:

AKTVENDIM

Pezullohet procedura e konfliktit administrativ sipas padisë së paditësit NTP “Mali-I” me seli në Mitrovicë, kundër të paditurit Organit Shqyrtues të Prokurimit me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit me numër 492, 498, 503/19 të datës 29.10.2019 së të paditurit.

ARSYETIM

Paditësi më datë 25.11.2019 në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative ka ushtruar padi, kundër të Paditurit, me të cilën i ka kërkuar anulimin e vendimit me numër 492, 498, 503/19 i datës 29.10.2019 së të paditurit.

Megjithatë Paditësi gjatë seancës për shqyrtimin kryesor datës 08.05.2024 e ka tërhequr padinë.

Duke marr për bazë se sipas nenit 31 para.1 të LKA-së paditësi mund të heqë dorë nga padia derisa të mos merret vendimi dhe se në këtë rast gjykata e pezullon, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Gjkata sheh të arsyeshme të sqaroj se, në konfliktit administrativ, sipas nenit të cituar më lartë, nuk kërkohet pëlqimi i të Paditurit për tërheqjen e padisë, rrjedhimisht nuk e mori mendimin e të Paditurit.

Për këto arsye gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjkata Komerciale e Kosovës

Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti i Përgjithshëm

KA.nr.213/22

Gjyqtari

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.